

Nr. Re nd or	Data e regjist rimit	Objekti	Data e kthimit të përgjigjes	Përmbajtja e përgjigjes	Mënyra e përfundimit të kërkesës (E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar)	Tarifa e shërbimit
Periudha Janar 2024						
1	11.01.2024	Kërkesë për informacion ardhur nga një individ me shkresë, në lidhje me vënien në dispozicion të një projektakti dhe relacioni	25.01.2024	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion të datës 9.1.2024, protokolluar më tonën nr. 205, datë 11.1.2024, nëpërmjet së cilës kërkoni t’ju vihet në dispozicion një faksimile e njësuar me origjinalin e projektaktit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar”, ju sqarojmë si më poshtë vijon: Programi analitik i projektakteve është lista e projektakteve që parashikohen të hartohen dhe të paraqiten për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Ministrave, sipas programit të ministrive. Për vitin 2024, program i përgjithshëm analitik i projektakteve është miratuar me vendimin nr. 790, datë 28.12.2023, të Këshillit të Ministrave. Referuar vendimit të sipërpërmendur, projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar” është planifikuar të paraqitet pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, me qëllim shqyrtimin në mbledhjen e Këshillit të Ministrave, katërmujorin III të vitit 2024. Aktualisht, Departamenti i Administratës Publike është në fazën e vlerësimit dhe diskutimit paraprak brenda institucionit të nismës për propozimin e projektligjit, fazë e cila i paraprin fillimit të procesit të hartimit të projektaktit. Në kushtet në të cilat ende nuk ka një projektakt që e materializon këtë nismë ligjore, DAP është në pamundësi për t’ju vënë në dispozicion një kopje të njësuar me origjinalin të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar”. Përveç sa më sipër, theksojmë se pas hartimit të tij, projektligji në fjalë do t’i nënshtrohet procedurës së njoftimit dhe konsultimit publik, me qëllim garantimin e transparencës dhe pjesëmarrjes së publikut në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse nga organet publike. Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,	E refuzuar	Nuk ka

2	22.01.2024	Kërkesë për informacion ardhur nga një individ me shkresë, në lidhje me vënien në dispozicion	01.02.2024	Dërguar për trajtim tek autoriteti kompetent	E deleguar	Nuk ka
3	09.02.2024	Kërkesë për informacion ardhur nga një organizatë me shkresë, në lidhje me largimet nga puna në administratë publike	13.02.2024	Përgjigja nr. 1 bashkëlidhur	E kufizuar/ Informacioni i kërkuar disponohet pjesërisht	Nuk ka

4	19.02.2024	Kërkesë për informacion nga një individ drejtuar një institucioni tjetër, dhe për dijeni DAP, në lidhje me konfirmimin si nëpunës civil.	26.02.2024	Trajtuar jashtë objektit të ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, pasi u komunikua me kërkuesin në lidhje me përcaktimin e informacionit të kërkuar nga institucioni.	Jashtë objektit të ligjit.	Nuk ka
5	27.02.2024	Kërkesë për informacion dërguar për trajtim nga një institucion tjetër në lidhje me largimet nga administrata publike.	04.03.2024	Përgjigja nr. 2 bashkëlidhur	E kufizuar/ Informacioni i kërkuar disponohet pjesërisht	Nuk ka

6	27.02.2024	Kërkesë për informacion ardhur nga një individ me email, në lidhje me programet e ndryshme për rekrutim në administratën publike.	12.03.2024	Përgjigja nr. 3 bashkëlidhur	E kufizuar/ Informacioni i kërkuar disponohet pjesërisht	Nuk ka
7	13.03.2024	Kërkesë për informacion ardhur nga një emision investigativ, në lidhje me emërimet dhe transferimet e një sërë nëpunësish në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.	Proces	Proces- Shtyrë afati i trajtimit me 5 ditë pune	Proces	Nuk ka

8	18.03.2024	Kërkesë për informacion dërguar për trajtim nga një institucion tjetër në lidhje me politikat fiskale të punësimit në administratë publike	25.03.2024	Përsëritje Në vijim të kërkesës për informacion të znj. A. K., përcjellë nga ana juaj bazuar në germën “d”, të nenit 10 të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar, ju bëjmë me dije se: Në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar, përcaktohet se: "Në qoftë se pas shqyrtimit të kërkesës autoriteti publik konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ai, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës, ia dërgon atë autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkuuesin. Arsyeja e vetme që justifikon dërgimin e kërkesës një autoriteti tjetër është mungesa e informacionit të kërkuar." Ndërkohë, në nenin 22, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, ndër të tjera, përcaktohet se: "Pranimi në shërbimin civil 1. Pranimi në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive bëhet nëpërmjet një konkurrimi të hapur. 2. Konkurrimi organizohet në mënyrë periodike nga njësia përgjegjëse për secilin nga grupet e përcaktuara në pikën 8 të nenit 19 të këtij ligji..." Për më tepër, në germën “a” dhe “f”, të pikës 1, nenit 4, të këtij ligji, përcaktohet se: “a) “Institucion i administratës shtetërore” është aparati i Këshillit të Ministrave, ministritë, institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit apo ministrave, përfshirë degët e tyre territoriale, si dhe administrata e prefektit . f) “Njësi përgjegjëse” është Departamenti i Administratës Publike (DAP) për institucionet e administratës shtetërore dhe njësia e burimeve njerëzore për institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore.” Për sa më sipër, DAP, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, organizon konkurrimet për sa i përket pranimin në shërbim civil të nëpunësve civilë, vetëm për institucionet e administratës shtetërore dhe nuk ka të dhëna mbi punësimet e kategorive të ndryshme të punonjësve, në administratën publike. Në këto kushte DAP nuk është autoriteti kompetent për të trajtuar kërkesën për informacion të znj.K Për sa i përket shpenzimeve për organizimin e konkurrenive për pranimin në shërbim civil të nëpunësve civilë, DAP është institucion buxhetor dhe si i tillë buxheti i tij miratohet dhe zbatohet sipas ligjit të buxhetit. Për cdo informacion më të detajuar mund të aksesohet në faqen zyrtare https://www.dap.gov.al/, në rubrikat Dokumente-Buxheti. Duke ju falenderuar për bashkëpunimin	Kthyer te institucioni fillestar duke mbajtur në dijeni kërkuuesin.	Nuk ka
---	------------	--	------------	---	---	--------

9	02.04.2024	Kërkesë për informacion ardhur nga një emision investigativ, në lidhje me emërimin në administratën tatimore të një nëpunëseje të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve	04.04.2024	Përsëritje, Në vijim të kërkesës suaj për informim me e-mailin e datës 29.03.2024, përcjellë në adresën e kontaktit të DAP dhe regjistruar në datën 02.04.2024, Departamenti i Administratës Publike (DAP), bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju sqaron si vijon: Kërkesa juaj për informim është regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2024 të DAP-it, me numrin rendor 9, sipas detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", të ndryshuar. Për çdo kërkesë tuajën për informim ju mund t'i drejtoheni adresës së kontaktit të pasqyruar në faqen tonë zyrtare: info@dap.gov.al Për sa i përket pyetjeve tuaja, në zbatim të vendimit nr. 767, datë 15.12.2021 “Për hapjen e procedurës së pranimit në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil, për vitin 2021”, nenin 26, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe Kreun II dhe III, të vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, të ndryshuar, Departamenti i Administratës Publike ka shpallur procedurën e lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit nga jashtë shërbimit civil me kodin #3818, për pozicionin: Zëvendësdyrëtor i Përgjithshëm i Hartimit të Programeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve- kategoria: II-b. Në përfundim të procedurës së konkurrimit është shpallur fituese me pranim nga jashtë shërbimit civil znj. E. Ç., e cila është emëruar në pozicionin Zëvendësdyrëtor i Përgjithshëm i Hartimit të Programeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve- kategoria: II-b, me aktin nr. 1039 prot, datë 14.02.2022, të DAP. Duke ju falenderuar për mirëkuptimin, Departamenti i Administratës Publike	E plotë	Nuk ka
---	------------	--	------------	---	---------	--------

10	05.04.2024	Kërkesë për informacion me email në lidhje me statusin e një shkrese	08.04.2024	Përsëritje, Në vijim të kërkesës suaj për informim me e-mailin e datës 02.04.2024, regjistruar në datën 05.04.2024, Departamenti i Administratës Publike (DAP), bazuar në ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, ju sqaron si vijon: Kërkesa juaj për informim është regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2024 të DAP-it, me numrin rendor 10, sipas detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", të ndryshuar. Për çdo kërkesë tuajën për informim ju mund t'i drejtoheni adresës së kontaktit të pasqyruar në faqen tonë zyrtare: info@dap.gov.al Në përgjigje të shkresës suaj përmes së cilës keni kërkuar përfundimin e pezullimit dhe rikthimin në shërbimin civil, DAP me shkresën nr.1254/1 prot., datë 27.03.2024 me lëndë " Kërkesë për bashkëpunim mbi sistemin në përfundim të periudhës së pezullimit" i ka kërkuar Ministrisë së Mbrojtjes të shprehet lidhur me sistemin tuaj. Bashkëlidhur gjeni shkresën e sipërcituar drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes, ku jeni mbajtur për dijeni. Shkresa ju është përcjellë zyrtarisht me postë në adresën tuaj dhe është kthyer nga posta me arsyetimin "adresa e pasaktë". Për sa më sipër, jeni të lutur të jepni një adresë të saktë postare , ose të paraqiteni pranë zyrave tona për të marrë shkresën. Faleminderit për mirëkuptimin	E plotë	Nuk ka
11	17.04.2024	Kërkesë për informacion me email në lidhje me pensionin suplementar	19.04.2024	Përgjigja nr. 5 bashkëlidhur	E plotë	Nuk ka

12	18.04.2024	Kërkesë për informacion me email në lidhje me emaillet zyrtare të nëpunësve të ministrive.	23.04.2024	Referuar fushës së përgjegjësisë së DAP, përcaktuar në nenin 7, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Departamenti i Administratës Publike nuk ka tagrin ligjor të japë lejen për zhvillimin e pyetësorëve në administratën shtetërore. Për më tepër DAP nuk disponon listën e emaileve zyrtare të gjithë nëpunësve civilë në ministritë e linjës.	E refuzuar/ Nuk disponohet informacioni i kërkuar	Nuk ka
----	------------	--	------------	--	--	--------

13	18.04.2024	Kërkesë për informacion me email në lidhje me Autoritetin e Kontrollit të Eksporteve.	22.04.2024	Përsëritje, Në vijim të kërkesës suaj për informacion, përpara parashikon ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Departamenti i Administratës Publike (DAP), sqaron se: Në pikën 2, të nenit 7, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, përcaktohen detyrat e Departamentit të Administratës Publike (DAP). Më konkretisht në këtë dispozitë parashikohet se: “2. DAP-i ka këto detyra: a) përgatit dhe mbikëqyr zbatimin e politikave shtetërore në shërbimin civil; b) përgatit projekt-aktet ligjore dhe nënligjore për shërbimin civil; c) mbikëqyr zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore; ç) përgatit mendim për çdo projekt-akt të propozuar nga institucionet e tjera që ka të bëjë me marrëdhëniet e punësimit në administratën publike; d) miraton dhe ndjek zbatimin e programeve të trajnimit në shërbimin civil; dh) përgatit planin vjetor të pranimit për institucionet e administratës shtetërore...” Për më tepër, në gërmën “a” dhe “f”, të pikës 1, nenit 4, të këtij ligji, përcaktohet se: “a) “Institucion i administratës shtetërore” është aparati i Këshillit të Ministrave, ministritë, institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit apo ministrave, përfshirë degët e tyre territoriale, si dhe administrata e prefektit f) “Njësi përgjegjëse” është Departamenti i Administratës Publike (DAP) për institucionet e administratës shtetërore dhe njësi e burimeve njerëzore për institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore.” Për sa më sipër, referuar dispozitave të sipërcituara ku përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e institucionit, ju bëjmë me dije se DAP-i është njësi përgjegjëse vetëm për administratën shtetërore, përbërja e së cilës përcaktohet më lart. Konkretisht, DAP nuk është njësi përgjegjëse për Autoritetin e Kontrollit Shtetëror të Eksporteve. Faleminderit për mirëkuptimin,	E refuzuar/Nuk disponohet informacioni i kërkuar	Nuk ka
----	------------	---	------------	--	--	--------

14	25.04.2024	Kërkesë për informacion me email në lidhje me datën e emërimit të një nëpunësi të dalë në pension.	03.05.2024	Dërguar për trajtim tek autoriteti kompetent	E deleguar	Nuk ka
15	26.04.2024	Kërkesë për informacion me email në lidhje me studentet ekselente.	14.05.2024	Përgjigje nr. 6 bashkëlidhur	E plotë	Nuk ka
16	15.05.2024	Kërkesë për informacion me email në lidhje me aktet e vlerësimit për një procedure konkurrimi	24.05.2024	Përgjigje nr. 7 bashkëlidhur	E plotë	Nuk ka

17	28.05.2024	Kërkesë për informacion me shkresë zyrtare në lidhje me numrat e inspektorëve dhe drejtorëve të përgjithshëm në një institucion të pavarur	10.06.2024	Përgjigje nr. 8 bashkëlidhur	E refuzuar/Nuk disponohet informacioni i kërkuar	Nuk ka
----	------------	--	------------	------------------------------	--	--------

18	03.06.2024	Kërkesë për informacion me email në lidhje me numrin e punonjësve të administratës publike në nivel qendror, për vitin 2023.	10.06.2024	Përsëritje znj. Sh., Në vijim të kërkesës suaj për informim me e-mailin e datës 03.06.2024, ku bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar, kërkon të dhëna lidhur me numrin total të punonjësve në administratën publike në nivel qendror, për vitin 2023, si dhe ndarjen e tyre sipas gjinisë, moshës dhe aftësisë së kufizuar, ju sqarojmë si vijon: Kërkesa juaj për informim është regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2024 të DAP-it, me numrin rendor 18, sipas detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", të ndryshuar. Për çdo kërkesë tuajën për informim ju mund t'i drejtoheni adresës së kontaktit të pasqyruar në faqen tonë zyrtare: info@dap.gov.al Në lidhje me kërkesat tuaja sqarojmë se, në pikën 2, të nenit 7, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, përcaktohen detyrat e Departamentit të Administratës Publike (DAP). Më konkretisht në këtë dispozitë parashikohet se: “2. DAP-i ka këto detyra: a) përgatit dhe mbikëqyr zbatimin e politikave shtetërore në shërbimin civil...” Për më tepër, në gërmën “a” dhe “f”, të pikës 1, nenit 4, të këtij ligji, përcaktohet se: “a) “Institucion i administratës shtetërore” është aparati i Këshillit të Ministrave, ministritë, institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit apo ministrave, përfshirë degët e tyre territoriale, si dhe administrata e prefektit . f) “Njësi përgjegjëse” është Departamenti i Administratës Publike (DAP) për institucionet e administratës shtetërore dhe njësia e burimeve njerëzore për institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore.” Për sa më sipër, referuar dispozitave të sipërcituara ku përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e institucionit, ju bëjmë me dije se DAP-i është njësi përgjegjëse vetëm për administratën shtetërore, përbërja e së cilës përcaktohet më lart. Në çdo rast, fusha e veprimtarisë së institucionit shtrihet vetëm në shërbimin civil. Në këto kushte DAP, nuk e disponon informacionin e kërkuar nga ana juaj. Duke ju falenderuar për mirëkuptimin, Departamenti i Administratës Publike	E refuzuar/Nuk disponohet informacioni i kërkuar	Nuk ka
19	21.06.2024	Kërkesë për informacion me email në lidhje me disa nëpunës të AKU për vitet 2017-2018.	01.07.2024	Përgjigje nr. 9 bashkëlidhur	E kufizuar/Informacioni nuk është përcjellë në të gjitha format e kërkuara	Nuk ka

20	02.07.2024	Kërkesë për informacion me email në lidhje me një procedurë rekrutimi.	15.07.2024	Përgjigje nr. 10 bashkëlidhur	E kufizuar/Informacioni nuk është përcjellë i plotë për shkak se kërkohen të dhëna personale	Nuk ka
----	------------	--	------------	-------------------------------	--	--------

21	03.07.2024	Kërkesë për informacion me email në lidhje me një Komision Disiplinor të AKU për vitet 2017-2018.	15.07.2024	Përsëritje, Në përgjigje të kërkesës tuaj për informim të datës 02.07.2024, regjistruar në datën 03.07.2024, ju bëjmë me dije se, kjo kërkesë është regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2024 të Departamentit të Administratës Publike (DAP), me numrin rendor 21, sipas detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", të ndryshuar. Për çdo kërkesë tjetër për informim ju mund t'i drejtoheni adresës së kontaktit info@dap.gov.al. Në vijim të pyetjeve tuaja ju sqarojmë se, DAP është përgjigjur me emailin e datës 01.07.2024 dhe shkresën nr.3610 datë 05.07.2024, ku ju ka informuar se përbërja e Komisionit Disiplinor në institucionet e administratës shtetërore është përcaktuar në mënyrë të qartë dhe shteruese në pikën 2, të Kreut I, të VKM-së nr. 115/2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil", të ndryshuar. Për më tepër, jurisprudenca shqiptare është e qartë për sa i takon organit kompetent për trajtimin e problemeve që rrjedhin nga zbatimi dhe interpretimi i ligjit. Në vendimin nr. 11 datë 23.04.2009 Gjykata Kushtetuese shprehimisht ka përcaktuar se: "Problemet e zbatimit dhe të interpretimit të ligjit, duke përfshirë edhe dispozitat për kompetencën, u takojnë në parim gjykatave të pushtetit gjyqësor." Gjithashtu, në pikën 3, të nenin 41, të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, përcaktohet se: "...3. Nëpunësi civil ka të drejtë të ankohet në gjykatën kompetente për mosmarrëveshjet administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi, që i cenon të drejtat dhe interesat e tij të ligjshme në marrëdhënien e shërbimit civil" Nga ana tjetër, në gërmën "b", të nenit 129, të Kodit të Procedurave Administrative parashikohet shprehimisht se: "Shterimi i ankimit administrativ, është kusht paraprak për ngritjen e padisë në gjykatën kompetente për çështjet administrative, përveç rasteve kur: ...b) ligji parashikon shprehimisht të drejtën për t'u ankuar drejtpërdrejt në gjykatë..." Në këto kushte, referuar dispozitave të sipërcituara, për çdo pretendim lidhur me zbatimin dhe interpretimin e dispozitave për përbërjen e Komisionit Disiplinor ngritur pranë AKU-së me Urdhrin nr. 5248/1 datë 06.12.2017, që keni bashkëlidhur, ju mund t'i drejtoheni gjykatës kompetente për mosmarrëveshjet administrative. Në çdo rast, për çdo dokumentacion apo sqarim të mëtejshëm lidhur me Komisionin Disiplinor në fjalë, ju duhet t'i drejtoheni institucionit pranë të cilit ky organ është ngritur, pra AKU-së. Duke ju falenderuar për mirëkuptimin, Departamenti i Administratës Publike	Jashtë objektit të ligjit.	Nuk ka
----	------------	---	------------	--	----------------------------	--------

22	03.07.2024	Kërkesë për informacion me shkresë për statusin e këshilltarëve të Këshillit Bashkiak Fier.	17.07.2024	Në vijim të kërkesës suaj për informim me nr. 2205 prot., datë 28.06.2024, protokolluar me tonën nr. 3562, datë 03.07.2024, nëpërmjet së cilës, bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, kërkohet informacion se cilët nga anëtarët e Këshillit Bashkiak Fier kanë statusin e nëpunësit civil, ju bëjmë me dije se: Referuar pikës I të nenit 4, të ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar, përcaktohet se, Departamenti i Administratës Publike (DAP), është njësi përgjegjëse vetëm për institucionet e administratës shtetërore ku përfshihet aparati i Këshillit të Ministrave, ministritë, institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit apo ministrave, përfshirë degët e tyre territoriale, si dhe administrata e prefektit. Ndërkohë, për institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, njësi përgjegjëse është njësia e burimeve njerëzore. Për më tepër, në pikën 1, të kreut I, të vendimit nr. 833, datë 28.10.2022 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, përcaktohet se: “Institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara të krijojnë e të administrojnë dosjen e personelit të çdo të punësuarit në institucionin e tyre.” Të dhënat e anëtarëve të Këshillit Bashkiak Fier për të cilët kërkoni informacion nëse kanë statusin e nëpunësit civil nuk janë të plota, pasi nuk përfshihet atësia dhe numri i tyre personal (ID). Në këto kushte, DAP nuk mund të përcjellë informacionin e kërkuar nga ana juaj. Kjo kërkesë është regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2024 të (DAP), me numrin rendor 22, sipas detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", të ndryshuar. Për pdo kërkesë tjetër për informim ju mund t'i drejtoheni adresës së kontaktit info@dap.gov.al.	E refuzuar/Nuk mund të verifikohet informacioni i kërkuar	Nuk ka
----	------------	---	------------	--	---	--------

23	08.07.2024	Kërkesë për informacion me shkresë lidhur me kreditet e programit shkollor.	22.07.2024	Përgjigje nr.11 bashkëlidhur	E plotë për sa disponohet/pje sërisht e deleguar	Nuk ka
----	------------	---	------------	------------------------------	--	--------

24	22.07.2024	Kërkesë për informacion në lidhje me punonjësit e administratës shtetërore	05.08.2024	Përsëritje, Në përgjigje të kërkesës tuaj për informim të datës 22.07.2024, ju bëjmë me dije se, kjo kërkesë është regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2024 të DAP-it, me numrin rendor 24, sipas detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", të ndryshuar. Për çdo kërkesë tjetër për informim ju mund t'i drejtoheni adresës së kontaktit info@dap.gov.al. Lidhur me pyetjet tuaja, ashtu si ju kemi sqaruar dhe në komunikimet tona të mëparshme, në gërmën "a" dhe "f", të pikës 1, nenit 4, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, përcaktohet se: "a) "Institucion i administratës shtetërore" është aparati i Këshillit të Ministrave, ministritë, institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit apo ministrave, përfshirë degët e tyre territoriale, si dhe administrata e prefektit. f) "Njësi përgjegjëse" është Departamenti i Administratës Publike (DAP) për institucionet e administratës shtetërore dhe njësia e burimeve njerëzore për institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore." Për sa më sipër, DAP-i është njësi përgjegjëse për administratën shtetërore, si dhe në çdo rast, referuar nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, të ndryshuar, ku përcaktohen detyrat dhe kompetencat e institucionit, fusha e veprimtarisë së DAP shtrihet vetëm në shërbimin civil. Ndërkohë, detyrat dhe kompetencat e DAP, si njësi përgjegjëse për administratën shtetërore, janë të mirëpërcaktuara në dispozitat e ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar. Ato përfshijnë organizimin e procedurave të konkurrimit në shërbim civil dhe emërimin e kandidatëve fitues, nxjerrjen e akteve të transferimit për shkak të ristrukturimit, paaftësisë shëndetësore, konfliktit të interesit apo dhe rikthimit nga pezullimi, zbatimit të vendimeve gjyqësore për rikthimin e nëpunësve civilë në detyrë etj. Rrjedhimisht të dhënat që DAP administron dhe përpunon, lidhen ngushtësisht me detyrat dhe kompetencat që janë përcaktuar në ligj, qoftë si kompetenca ekskluzive të institucionit, apo si kompetenca të DAP, si njësi përgjegjëse për administratën shtetërore. Në këto kushte, ju ritheksojmë se teksa ju keni kërkuar informacion të detajuar mbi numrin total të punonjësve në administratë shtetërore, ndarjen e tyre sipas gjinisë, moshës etj, DAP nuk disponon të dhëna lidhur me sa ju kërkon, por ju mund t'i referoheni të dhënave të publikuara në Raportet Vjetore për Shërbimin Civil në linkun: https://www.dap.gov.al/publikime/raporte-vjetore.	E refuzuar/Nuk disponohet informacioni i kërkuar	Nuk ka
----	------------	--	------------	--	--	--------

25	26.07.2024	Kërkesë për informacion lidhur me strukturën e një institucioni	30.07.2024	Në përgjigje të emailit tuaj të datës 26.7.2024, përmes së cilit keni përcjellë kërkesën për informacion në lidhje me strukturën e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, ju bëjmë me dije se struktura e këtij institucioni nuk është miratuar ende. Sakaq ju informojmë se, kjo kërkesë është regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2024 të Departamentit të Administratës Publike (DAP), me numrin rendor 25, sipas detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", të ndryshuar. Për çdo kërkesë tjetër për informim ju mund t'i drejtoheni adresës së kontaktit info@dap.gov.al." Faleminderit,	E plotë	Nuk ka
26	31.07.2024	Kërkesë për informacion lidhur me strukturën e një institucioni dhe pozicionet vakante në institucion	13.08.2024	Lidhur me pozicionet vakante kërkuesi është informuar që institucioni është në proces ristrukturimi, ndërsa struktura përcjellë sipas Përgjigjes nr.12 bashkëlidhur	E plotë	Nuk ka
27	02.08.2024	Kërkesë për informacion lidhur me strukturën e propozuar të një institucioni	13.08.2024	Përgjigja nr. 13 bashkëlidhur	E plotë	Nuk ka

28	05.08.2024	Kërkesë për informacion lidhur me shpalljen e disa pozicioneve vakante pranë MTM	07.08.2024	Përsëndetje z. H., Në përgjigje të kërkesës tuaj për informim të datës 05.08.2024, ju bëjmë me dije se, kjo kërkesë është regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2024 të DAP-it, me numrin rendor 28, sipas detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", të ndryshuar. Për çdo kërkesë tjetër për informim ju mund t'i drejtoheni adresës së kontaktit info@dap.gov.al. Lidhur me pyetjen tuaj se, kur do të jenë të disponueshëm për aplikim 3 pozicionet e Drejtorive në MTM, që keni listuar, ju sqarojmë se: Në zbatim të pikës 10, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, VKM -së nr. 108, datë 26.02.2014, "Për planin vjetor të pranimi në shërbimin civil", VKM -së nr. 62, datë 07.02.2024, "Për planin vjetor të pranimi, për vitin 2024, në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil", i ndryshuar, çdo institucion krijon njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore e cila është përgjegjëse për menaxhimin e nëpunësve civilë të institucionit. Gjithashtu njësia e burimeve njerëzore e çdo institucioni është përgjegjëse për hartimin e planit të konsoliduar të nevojave për rekrutim për të gjithë sistemin përkatës që përfshin aparatën e tij dhe institucionet e varësisë. Si e tillë, është njësia e burimeve njerëzore të institucionit e cila përcjellë pranë Departamentit të Administratës Publike (DAP) kërkesat për plotësimin e vakancave në institucionin përkatës, në kuadër të implementimit të planit vjetor të pranimi në shërbimin civil, duke mbajtur në konsideratë dhe krijimin e vakancës. Kërkesa për shpallje e pozicioneve vakante është e domosdoshme pasi duhet të përcillen të gjithë elementët kryesorë që përmban shpallja, në zbatim të pikës 9, kreut II, të VKM -së nr. 243, datë 18.3.2015, "për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive", i ndryshuar, dhe pikës 8, të kreut II, të VKM -së nr. 242., datë 18.03.2015, "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese", i ndryshuar, siç janë ndër të tjera: Pozicioni/et i/e punës që është/janë vakant; Përshkrimi i përgjithshëm i punës për të cilin/at do të zhvillohet procedura e konkurrimit; Fusha e njohurive, aftësitë dhe cilësitë që do të vlerësohen në intervistën e strukturuar me gojë/testimin me shkrim; Kërkesat e veçanta (lloji dhe niveli i arsimit, përvoja, trajnimet apo kritere të tjera të posacme); Sa më sipër, DAP do të vijojë me shpalljen e vakancave për të cilat keni shprehur interesin në kërkesën tuaj, pas përcjelljes nga ana e burimeve njerëzore të institucionit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të kërkesës për publikimin e tyre. Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.	E plotë	Nuk ka
----	------------	--	------------	--	---------	--------

29	13.08.2024	Kërkesë për informacion lidhur me nëpunës të administratës publike në zgjedhjet vendore Himarë	15.08.2024	Përgjigja nr. 14 bashkëlidhur	E kufizuar/informacioni disponohet pjesërisht	Nuk ka
30	13.08.2024	Kërkesë për informacion lidhur me zhvillimin e provimeve me programe kompjuterike	23.08.2024	Nuk disponohet informacioni i kërkuar pasi DAP nuk zhvillon provime me programe kompjuterike	E refuzuar/ Nuk disponohet informacioni i kërkuar	Nuk ka
31	16.08.2024	Kërkesë për informacion lidhur me përshkrimet e punës në një institucion	09.09.2024	Përgjigja nr. 16 bashkëlidhur	E plotë	Nuk ka (Dërguar elektronikisht)

32	16.08.2024	Kërkesë për informacion lidhur me Komisionin e Ristrukturimit në një institucion	30.08.2024	Përgjigja nr. 15 bashkëlidhur	E plotë	Nuk ka
33	25.09.2024	Kërkesë për informacion lidhur me vlerësimet e punës të disa nëpunësve të një institucioni tjetër, për 6 mujin e dytë 2023 dhe 6 mujin e parë 2024	30.09.2024	Dërguar për trajtim tek autoriteti kompetent	E deleguar	Nuk ka

34	30.09.2024	Kërkesë për informacion lidhur me punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit	09.10.2024	Dërguar për trajtim tek autoriteti kompetent	E deleguar	Nuk ka
35	02.10.2024	Kërkesë për informacion lidhur me hartimin e një VKM-je dërguar për trajtim nga një institucion tjetër	04.10.2024	Përsëritje znj. Y. Në vijim të kërkesës tuaj për informim të datës 27.09.2024, drejtuar Kryeministrit dhe dërguar për trajtim në Departamentin e Administratës Publike, ku kërkohet informacion lidhur me hartimin dhe miratimin e një vendimi të Këshillit të Ministrave, në zbatim të pikës 4 e në vijim, të nenit 10, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, ju bëjmë me dije se VKM-ja, së cilës i referoheni, është në proces vlerësimi. Gjithashtu, ju bëjmë me dije se, kërkesa juaj është regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2024 të DAP-it, me numrin rendor 35, sipas detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", të ndryshuar. Për çdo kërkesë tjetër për informim ju mund t'i drejtoheni adresës së kontaktit info@dap.gov.al. Duke ju falenderuar për mirëkuptimin, Departamenti i Administratës Publike	E plotë	Nuk ka

36	09.10.2024	Kërkesë për informacion lidhur me aktet e emërimit të një nëpunësi civil	14.10.2024	Përsëritje z. Gj., Në përgjigje të kërkesës tuaj për informim të datës 09.10.2024, ju bëjmë me dije se lidhur me sa kërkon, Departamenti i Administratës Publike ju është përgjigjur në mënyrë shteruese, me e-mailin e datës 20.12.2023, në vijim të kërkesës tuaj për informim të datës 7.12.2023. Gjithashtu, ju bëjmë me dije se, kërkesa juaj e datës 09.10.2024 është regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2024 të DAP-it, me numrin rendor 36, sipas detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", të ndryshuar. Për çdo kërkesë tjetër për informim ju mund t'i drejtoheni adresës së kontaktit info@dap.gov.al. Faleminderit,	E plotë	Nuk ka
----	------------	--	------------	---	---------	--------

37	17.10.2024	Kërkesë për informacion lidhur me pozicionet vakante në një institucion	31.10.2024	Në përgjigje të kërkesës suaj të datës 17.10.2024, përmes së cilës kërkon informacion lidhur me pozicionet vakante pranë institucionit të Avokaturës së Shtetit, Departamenti i Administratës Publike (DAP) bën me dije si më poshtë: Nga të dhënat që DAP administron, pozicionet aktualisht vakante, pjesë e shërbimit civil, pranë institucionit të Avokaturës së Shtetit janë: - Specialist (Redaktor) në Zyrën e Përfaqësimit Ligjor në Gjykatat Kombëtare, në Avokaturën e Shtetit, klasa e pagës IV-1; - Specialist në Zyrën e Përfaqësimit Ligjor në Gjykatat Kombëtare, në Avokaturën e Shtetit, klasa e pagës IV-2; - Specialist (Statistike) në Zyrën e Përfaqësimit Ligjor në Gjykatat Kombëtare, në Avokaturën e Shtetit, klasa e pagës IV-2; - Jurist në Strasburg në Zyrën e Përfaqësimit në Gjykatat e Huaja, Ndërkombëtare dhe Arbitrazhin Ndërkombëtar, në Avokaturën e Shtetit; - Specialist (Përkthyes) në Zyrën e Përfaqësimit në Gjykatat e Huaja, Ndërkombëtare dhe Arbitrazhin Ndërkombëtar, në Avokaturën e Shtetit, klasa e pagës IV-1; - Specialist (Përkthyes) në Zyrën e Përfaqësimit në Gjykatat e Huaja, Ndërkombëtare dhe Arbitrazhin Ndërkombëtar, në Avokaturën e Shtetit, klasa e pagës IV-1; - Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Avokaturën e Shtetit, klasa e pagës II-2; - Specialist (Finance) në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Avokaturën e Shtetit, klasa e pagës IV-2; - Specialist (për burimet njerëzore), në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Avokaturën e Shtetit, klasa e pagës IV-2; - Specialist (për prokurimet publike), në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Avokaturën e Shtetit, klasa e pagës IV-2; - Specialist (Arkiv Protokolli), në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Avokaturën e Shtetit, klasa e pagës IV-2. Gjithashtu, ju bëjmë me dije se, kërkesa juaj është regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2024 të DAP-it, me numrin rendor 37, sipas detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", të ndryshuar. Për çdo kërkesë tjetër për informim ju mund t'i drejtoheni adresës së kontaktit info@dap.gov.al.	E plotë	Nuk ka
----	------------	---	------------	---	---------	--------

38	06.11.2024	Kërkesë për informacion lidhur me rikthimin ne detyrë me vendim gjyqësor të formës së prerë	18.11.2024	Përgjigja nr. 17 bashkëlidhur	E plotë	Nuk ka
39	21.11.2024	Kërkesë për informacion lidhur me konsultimin e dokumentit të Udhërrëfyest për Reformën në Administratën Publike 2023-2030	10.12.2024	Përgjigja nr. 18 bashkëlidhur	E plotë	Nuk ka

40	26.11.2024	Kërkesë për informacion lidhur me rikthimin ne detyrë me vendim gjyqësor të formës së prerë	13.12.2024	Në vijim të kërkesës tuaj për informim, protokolluar me tonën nr. 6024/2 prot, datë 26.11.2024, nëpërmjet së cilës, bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, kërkonti të informoheni lidhur me statusin tuaj si nëpunës civil dhe pozicionet e “Përgjegjësit të Sektorit të Shërbimeve” dhe “Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve”, të shpallura vakante nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) nga viti 2014-2024, ju bëjmë me dije se: Nga të dhënat që administrojmë rezulton se, me aktin nr. 1073/7 prot., datë 30.08.2007, jeni emëruar nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Shëndetësisë, si dhe me shkresën nr. 3908/2 prot., datë 27.10.2008 jeni konfirmuar në këtë pozicion nga Departamenti i Administratës Publike (DAP). Në lidhje me kërkesën tuaj për pozicionet e “Përgjegjësit të Sektorit të Shërbimeve” dhe “Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve”, të shpallura vakante nga MSHMS, ju informojmë se nga viti 2014-2024, janë shpallur 8 vende vakante në pozicionet e sipërcituara. Megjithatë, ashtu si ju kemi sqaruar me shkresën nr. 6024/1 prot., datë 18.11.2024, MSHMS, si institucioni debitor që ka detyrimin ligjor për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, në favorin tuaj, duhet ta ekzekutojë atë sipas procedurës dhe rregullave të parashikuara në Kreun IV, të Urdhrit nr. 5151, datë 28.10.2015, “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”. MSHMS-ja duhet të marrë masa të shqyrtojë mundësinë e sistemimit tuaj në një pozicion vakant, ku ju plotësoni kriteret e përgjithshme dhe të posaçme, me qëllim realizimin e të drejtës tuaj. Në përfundim, ju bëjmë me dije se kërkesa juaj është regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2024 të DAP-it, me numrin rendor 40, sipas detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar. Për çdo kërkesë tjetër, për informim, ju mund t’i drejtoheni adresës së kontaktit info@dap.gov.al. Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,	E plotë	Nuk ka
----	------------	---	------------	--	---------	--------

41	05.12.2024	Kërkesë për informacion lidhur me strukturat e Ministrive	20.12.2024	Në përgjigje të kërkesës suaj për informim, dërguar me emailin e datës 04.12.2024 dhe regjistruar më 05.12.2024, për tri pikat në përmbajtje të saj shprehemi sa më poshtë vijon: 1. Në lidhje me informacionin e kërkuar për strukturën e stafit përbërës të ministrive të linjës dhe aparatit të Kryeministrit, lutem gjeni bashkëlidhur në formë tabelare (Përgjigja nr. 19 bashkëlidhur) të dhënat mbi: Numrin e pozicioneve (të ndarë në kategoritë: staf politik, nëpunës civilë dhe punonjës administrativ), sipas strukturës së miratuar, për Kryeministrinë dhe ministrinë, në periudhat dhjetor 2023 dhe dhjetor 2024; Numrin e pozicioneve vakante, pjesë të shërbimit civil, për Kryeministrinë dhe ministrinë të linjës. Në këtë drejtim, vlen të sqarojmë sa më poshtë vijon: (i) DAP, në rolin e njësisë përgjegjëse, në kuptim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, disponon të dhëna vetëm pozicionet vakante me status të nëpunësit civil, në institucionet e administratës shtetërore; (ii) Numri i vakancave është një e dhënë dinamike, që ndryshon nga dita në ditë. Në shërbimin civil, pozicionet vakante krijohen si rezultat i mbushjes së moshës së pensionit të nëpunësve civilë, dorëheqjeve, pezullimit të marrëdhënies në shërbimin civil si dhe rasteve të tjera të lirim të parashikuara në legjislacionin e shërbimit civil, mobilitetit brenda shërbimit civil nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë apo si rezultat i shtimit të pozicioneve të reja në organikën e institucionit. Në këto kushte, është e pamundur që kjo e dhënë (numri i vakancave) të identifikohet për periudha të mëparshme. Sa më sipër, numri i pozicioneve vakante, në tabelën bashkëlidhur, i referohet datës së sotme. Gjithashtu, theksojmë se nga numri në total i vakancave, për 159 prej tyre, procedurat e konkurrimit janë në proces. 2. Në lidhje me informacionin e kërkuar në pikën 2, bëjmë me dije se në faqen tonë zyrtare www.dap.gov.al gjeni të publikuara raportet vjetore të punës së Departamentit, ku një nënkre i dedikohet reformës funksional-strukturore të institucioneve të administratës. Në këtë pjesë të raportit pasqyrohen, në mënyrë të përmbledhur, ndryshimet që kanë ndodhur gjatë vitit kalendarik respektiv në drejtim të rishikimit funksional- strukturor të institucioneve ekzistuese, si dhe krijimit të institucioneve të reja. 3. Në bazë të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, Departamenti i Administratës Publike përgatit për Kryeministrin, projekturdrat për strukturën dhe organikën e institucioneve të administratës shtetërore, ku përfshihen: aparati i Kryeministrit, ministrinë, institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit apo ministrave. Në këto kushte, DAP nuk disponon informacion mbi strukturën dhe numrin e personelit të institucioneve kushtetuese dhe te pavarura te krijuara me ligj.	E plotë	Nuk ka
----	------------	---	------------	--	---------	--------

42	23.12.2024	Kërkesë për informacion lidhur me aktet e emërimit të një nëpunësi civil	10.01.2025	Përsëritje z. Gj., Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion mbi aktet e emërimit që kanë dalë në emër të znj. N. P., si pasojë e përzgjedhjes së saj në shpalljen me kod 4663, ju informojmë se: Departamenti i Administratës Publike për informacionin e sipërcituar, ju është përgjigjur në mënyrë shteruese me email-in e datës 23.10.2023 dhe me shkresën nr. 6338 prot., datë 20.12.2023, ku ka qenë për dijeni dhe Komisionieri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ky informacion ju është ritheksuar edhe me email-in datës 16.10.2024, përmes së cilit ju është bërë me dije gjithashtu dhe fakti që znj.N. P. aktualisht rezulton e emëruar në pozicionin Specialist në Sektorin e Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, në Drejtorinë e Integritetit, Mbikëqyrjes dhe Ankesave Administrative e Gjyqësore, në Departamentin e Administratës Publike, si rezultat i përzgjedhjes së pozicionit si kandidat fituese për procedurën e pranimi në shërbimin civil me kod 5925“Lloji i diplomës “Shkenca Juridike”, niveli minimal i diplomës “Master Profesional”. Përgjigjen me shkrim do ta merrni dhe zyrtarisht. Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!	E plotë	Nuk ka
----	------------	--	------------	---	---------	--------